

الدروس المهمة لعامة الأمة

**Mësime të rëndësishme për
popullin e thjeshtë**

Mësime të rëndësishme për popullin e thjeshtë

Abdulaziz ibën Abdullah ibën Baz

Mësime të rëndësishme për popullin e thjeshtë

nga hoxha dhe eruditi i nderuar

Abdulaziz ibën Abdullah ibën Baz

Allahu e pastë mëshiruar!

Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit!

Parathënia e autorit

Falënderimet i takojnë Allahut, Zotit të botëve, dhe fundi i lumtur është për të devotshmit. Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi robin dhe të Dërguarin e Tij, Profetin tonë, Muhamedin, mbi familjen dhe mbi gjithë shokët e tij!

Më tej themi:

Kjo është një broshurë e shkurtër rreth sqarimit të disa çështjeve që duhet të dijë publiku i gjerë lidhur me fenë Islame. E kam titulluar: "Mësime të rëndësishme për popullin e thjeshtë"

E lus Allahun që ta bëjë të dobishme për myslimanët dhe ta pranojë prej meje, vërtet Ai është Bujar dhe Fisnik.

Abdulaziz ibën Abdullah ibën Baz Mësime të rëndësishme për popullin e thjeshtë¹

Mësimi i parë: Surja el-Fatiha dhe suret e shkurtra.

Mësimi i sures el-Fatiha dhe sa të jetë e mundur nga suret e shkurtra, nga surja ez-Zelzele deri te surja en-Nas. Të diktohen gojarisht, të korrigjohen gabimet e leximit, të mësohen përmendësh dhe të shpjegohen çështjet që duhen kuptuar.

Mësimi i dytë: Shtyllat e Islamit.

Sqarimi i pesë shtyllave të Islamit, e para dhe më e madhja e të cilave është: Dëshmia se s'ka të adhuruar me të drejtë përveç Allahut dhe se Muhamedi është i Dërguari i Tij; me shpjegim të domethënies së saj, duke sqaruar kushtet e fjalës "la ilahe il-lallah", domethënia e së cilës është: (nuk ka të adhuruar) duke mohuar çdo gjë që adhurohet veç Allahut, (përveç Allahut) duke pohuar se adhurimi i takon vetëm Allahut, i Cili është Një i Vetëm dhe s'ka asnjë ortak. Kushtet e dëshmisë "La ilahe il-lallah" janë: dija që përjashton injorancën, bindja që përjashton dyshimin, sinqeriteti që përjashton shirkun, vërtetësia që përjashton gënjeshtren, dashuria që përjashton urrejtjen, nënshtrimi që përjashton lënien, pranimi që përjashton refuzimin, dhe mohimi i çdo gjëje që

¹ Koleksioni i Fetvave dhe Artikujve të Ndryshëm (3/288-298).

adhurohet përveç Allahut. Kushtet e lartpërmendura janë përmbledhur në dy vargjet e mëposhtme:

Dije, bindje, singeritet e vërtetësi

Me dashuri, nënshtrim e dakordësi Shtoi këtyre dhe një të tetë: të mohosh çdo gjë që përveç Allahut është konsideruar hyjni.

Gjithashtu duhet shpjeguar dëshmia se Muhamedi është i Dërguari i Allahut, kuptimi i së cilës është: besimi në atë që ai ka lajmëruar, zbatimi i urdhëresave të tij, shmangia e gjërave që i ka ndaluar dhe i ka kritikuar, dhe të mos adhurohet Allahu përveçse përmes mënyrës që ka ligjëruar Allahu i Lartësuar dhe i Dërguari i Tij ﷺ. Pastaj, nxënësit i shpjegohen shtyllat e mbetura nga pesë shtyllave e Islamit, që janë: namazi, zekati, agjërimi i Ramazanit dhe haxhillëku në Shtëpinë e Shenjtë të Allahut për atë që ka mundësi.

Mësimi i tretë: Shtyllat e Imanit (besimit).

Ato janë gjashtë: të besosh në Allahun, melekët e Tij, librat e Tij, të dërguarit e Tij, Ditën e Fundit dhe të besosh në kaderin se çdo gjë është caktuar nga Allahu i Lartësuar qoftë e mirë apo e keqe.

Mësimi i katërt: Llojet e teuhidit dhe llojet e shirkut.

Shpjegimi i llojeve të Teuhidit. Teuhidi ndahet në tre lloje: Teuhidi i Rububijes, Teuhidi i Uluhijes dhe Teuhidi i Emrave dhe Cilësive.

1) Teuhidi i Rububijes: besimi se Allahu i Lartësuar është Krijuesi i çdo gjëje dhe se Ai vendos për çdo gjë, pa patur asnjë ortak.

Teuhidi i Uluhijes: besimi se Allahu i Lartësuar është i vetmi që meriton të adhurohet me të drejtë, pa asnjë ortak. Ky është dhe kuptimi i fjalës "La ilahe il-la Allah", që do të thotë: nuk ka të adhuruar me të drejtë përveç Allahut. Të gjitha adhurimet, si namazi, agjërimi dhe të tjera, duhet t'i kushtohen vetëm Allahut dhe nuk lejohet që diçka nga ato t'i kushtohet dikujt tjetër.

3) Teuhidi i Emrave dhe Cilësive të Allahut: besimi në çdo gjë që është përmendur në Kuranin fisnik ose në hadithet e sakta nga emrat dhe cilësitë e Allahut, pohimi i tyre vetëm për Allahun në mënyrën që i takon Atij, pa shtrembërim, mohim, formësim apo përngjasim; në zbatim të fjalës së Allahut të Lartësuar:

(قُلْ هُوَ اللَّهُ أَحَدٌ 1 اللَّهُ الصَّمَدُ 2 لَمْ يَلِدْ وَلَمْ يُولَدْ 3 وَلَمْ يَكُنْ لَهُ كُفُوًا أَحَدٌ 4)

Thuaj: "Ai është Allahu, Një dhe i Vetëm.

Allahu është Absoluti (të Cilit i përgjërohet gjithçka në amshim).

Ai as nuk ka lindur kënd e as nuk është i lindur prej kujt.

Dhe askush nuk është i barabartë (a i krahasueshëm) me Atë". (El Ihlas, 1-4) Po ashtu, fjala tjetër e Tij:

(...أَلَيْسَ كَمِثْلِهِ شَيْءٌ وَهُوَ السَّمِيعُ الْبَصِيرُ)

"Asgjë nuk është si Ai. Ai është Gjithëdëgjuesi, Gjithëshikuesi". (Esh-Shura, 11) Disa prej dijetarëve e kanë ndarë atë në dy lloje, duke e klasifikuar Teuhidin e Emrave dhe Cilësive në Teuhidin e Rububijes. Kjo gjë nuk përbën ndonjë kundërshtim sepse qëllimi është i qartë në të dy llojet e ndarjes.

Shirku ndahet në tre lloje: shirk i madh, shirk i vogël dhe shirk i fshehtë.

Shirku i madh: i bën të pavlefshme veprat dhe bën që njeriu të qëndrojë përgjithmonë në Zjarr në mënyrë të detyrueshme, nëse vdes në këtë gjendje, sikurse ka thënë Allahu i Lartësuar:

﴿وَلَوْ أَشْرَكُوا لَحَبِطَ عَنْهُمْ مَا كَانُوا يَعْمَلُونَ﴾

"Por, nëse ata adhurojnë zota të tjerë, do t'u bëhet e pavlefshme çdo gjë nga ajo që kanë bërë". (El-Enam, 88) Po ashtu Allahu i Lartësuar thotë:

﴿مَا كَانَ لِلْمُشْرِكِينَ أَنْ يَعْمُرُوا مَسْجِدَ اللَّهِ شَاهِدِينَ عَلَى أَنْفُسِهِم بِالْكَفْرِ أُولَٰئِكَ حَبِطَتْ أَعْمَالُهُمْ وَفِي النَّارِ هُمْ خَالِدُونَ﴾ (17)

"Nuk u takon idhujtarëve të përkujdesen për faltoret e Allahut, përderisa edhe ata vetë dëshmojnë se janë jobesimtarë. Të kota do të jenë veprat e tyre dhe në zjarrin e Xhehenemit do të qëndrojnë përgjithmonë". (Et-Teube, 17) Dhe atij që vdes në këtë gjendje nuk do t'i falet, dhe Xheneti do t'i jetë i ndaluar për të, ashtu siç ka thënë Allahu i Lartësuar:

﴿إِنَّ اللَّهَ لَا يَغْفِرُ أَنْ يُشْرَكَ بِهِ وَيَغْفِرُ مَا دُونَ ذَلِكَ لِمَنْ يَشَاءُ...﴾

"Vërtet, Allahu nuk fal që të adhurohet dikush apo diçka tjetër veç Atij, por gjynahet e tjera më të vogla ia fal kujt të dojë..." (En-Nisa, 48), Gjithashtu Allahu i Lartësuar thotë:

﴿...إِنَّهُ مَنْ يُشْرِكْ بِاللَّهِ فَقَدْ حَرَّمَ اللَّهُ عَلَيْهِ الْجَنَّةَ وَمَأْوَاهُ النَّارُ وَمَا لِلظَّالِمِينَ مِنْ أَنْصَارٍ﴾

"Sigurisht, atij që adhuron tjetërkënd përveç Allahut, Allahu do t'ia ndalojë Xhenetin dhe strehim i tij do të jetë Zjarri. Për keqbërësit nuk ka ndihmës". (El-Maide, 72)

Prej llojeve të tij janë: lutja e të vdekurve dhe idhujve, kërkimi i ndihmës prej tyre, zotimi për ta, flijimi i kafshëve për ta, etj.

Shirku i vogël: është ai lloj i shirkut i cili është vërtetuar nga tekstet e Kuranit ose sunetit se quhet shirk, por nuk është i llojit të shirkut të madh, si: syfaqësia në disa vepra, betimi për dikë tjetër përveç Allahut, shprehja: "Siç ka dashur Allahu dhe siç ka dashur filani", si dhe shembuj të tjerë të ngjashëm me këto. Profeti (paqja qoftë mbi të) ka thënë:

«أَخَوْفُ مَا أَخَافُ عَلَيْكُمُ الشِّرْكَ الْأَصْغَرَ» فَسُئِلَ عَنْهُ، فَقَالَ: «الرِّيَاءُ» [2]

"Gjëja që kam më së shumti frikë për ju është shirku i vogël." Kur e pyetën se çfarë është ai, tha: "Syfaqësia".¹ Këtë hadith e shënojnë imam Ahmedi,

¹ E shënojnë Imam Ahmedi [5/428], Taberaniu në "El-Kebir" [4/338] dhe Bejhekiu në "Shuab" [14/355]. Në "Mexhme ez-Zevaid" [1/121] thuhet se

Taberaniu dhe Bejhakiu, përcjellë nga Mahmud bin Lebid el-Ensari (Allahu qoftë i kënaqur me të) me një zinxhir të mirë transmetuesish. Po ashtu e shënon Taberaniu me disa zinxhirë të mirë, përcjellë nga Mahmud bin Lebidi, nga Rafi bin Hudejxhi, nga Profeti ﷺ.

Si dhe hadithi i Profetit ﷺ:

«مَنْ حَلَفَ بِشَيْءٍ دُونَ اللَّهِ فَقَدْ أَشْرَكَ» [3]

"Kush betohet për diçka tjetër veç Allahut, ka bërë shirk"(3)¹ E shënon imam Ahmedi me zinxhir të saktë, nga Umeri biri i Hattabit, Allahu qoftë i kënaqur me të. E shënojnë gjithashtu Ebu Davudi dhe Tirmidhiu me një zinxhir të saktë transmetuesish, nga Ibën Umeri (Allahu qoftë i kënaqur me të!), nga Profeti (paqja qoftë mbi të!) se ka thënë:

«مَنْ حَلَفَ بِغَيْرِ اللَّهِ فَقَدْ كَفَرَ أَوْ أَشْرَكَ» [4]

"Ai që betohet për dikë tjetër përveç Allahut, ka bërë kufër ose shirk".(4)² Gjithashtu i Dërguari i Allahut ﷺ ka thënë:

«لَا تَقُولُوا: مَا شَاءَ اللَّهُ وَشَاءَ فُلَانٌ، وَلَكِنْ قُولُوا: مَا شَاءَ اللَّهُ ثُمَّ شَاءَ فُلَانٌ» [5]

"Mos thoni: "Siç ka dashur Allahu dhe siç ka dashur filani!", por thoni: "Siç ka dashur Allahu, pastaj siç

e ka transmetuar Ahmedi dhe se transmetuesit e tij i përkasin kategorisë së hadithit të saktë.

¹ Transmetoi Imam Ahmedi (1/47)

² E transmetuan Ebu Davudi, numër 3251 dhe Tirmidhiu, numër 1535.

ka dashur filani!"¹ E shënon Ebu Davudi me zinxhir të saktë të transmetuesve, nga Hudhejfe bin El-Jeman, Allahu qoftë i kënaqur me të.

Ky lloj i shirkut nuk të nxjerr nga feja islame dhe nuk e bën të detyrueshëm qëndrimin e përhershëm në Zjarr, por ai bie ndesh me përsosmërinë e teuhidit të detyrueshëm.

I treti: shirku i fshehtë i cili faktohet nga fjala e Profetit ﷺ:

«أَلَا أُخْبِرُكُمْ بِمَا هُوَ أَخْوَفُ عَلَيْكُمْ عِنْدِي مِنَ الْمَسِيحِ الدَّجَالِ؟» قَالُوا: بَلَى يَا رَسُولَ اللَّهِ، قَالَ: «الشِّرْكُ الْخَفِيُّ، يَقُومُ الرَّجُلُ فَيُصَلِّيَ فَيَزِيْنُ صَلَاتَهُ لِمَا يَرَى مِنْ نَظَرِ الرَّجُلِ إِلَيْهِ» [6]

"A doni t'ju tregoj për atë që kam më shumë frikë për ju sesa Mesihu i Rremë?" Të pranishmit i thanë: "Posi, o i Dërguari i Allahut!" Ai tha: "Shirku i fshehtë; kur njeriu ngrihet për të falur namazin dhe e zbukuron atë për shkak se po e shikojnë njerëzit." (6)² (E transmeton imam Ahmedi në Musnedin e tij, nga Ebu Seid el-Hudri, Allahu qoftë i kënaqur me të!)

Lejohet që shirku të ndahet vetëm në dy lloje:

Shirk i madh dhe shirk i vogël, ndërsa shirku i fshehtë i përfshin të dyja sepse ai nganjëherë mund të jetë shirk i madh, si shirku i hipokritëve, të cilët e fshehin besimin e tyre të gabuar dhe shfaqen si

¹ E transmetuan Ebu Davudi, numër 4980 dhe Ahmedi, 5/384

² E transmetuan Ibën Maxheh nr. 4204 dhe Imam Ahmedi 3/30.

muslimanë sa për sy e faqe dhe nga frika për veten e tyre.

Dhe nganjëherë mund të jetë shirk i vogël, si syfaqësia, ashtu siç është cekur në hadithin e Mahmud bin Lebid el-Ensari dhe hadithin e Ebu Seidi të cilët i kemi përmendur më parë. Suksesi është në Dorën e Allahut.

Mësimi i pestë: Ihsani (përsosmëria).

Shtylla e Ihsanit është: "Ta adhurosh Allahun sikurse të jesh duke e parë Atë; sepse edhe pse ti nuk e sheh Atë, Ai të sheh ty.

Mësimi i gjashtë: Kushtet e namazit.

Kushtet e namazit janë nëntë:

Islami, logjika, mosha e dallimit të keqes nga e mira, gusli ose abdesi, heqja e ndyrësive, mbulimi i pjesëve të turpshme, hyrja e kohës, kthimi nga kibla dhe nijeti.

Mësimi i shtatë: Shtyllat e namazit.

Shtyllat e namazit janë katërmbëdhjetë:

Qëndrimi në këmbë kur është e mundur, tekbiri fillestar, leximi i Fatihasë, rukuja, drejtimi pas rukusë, sexhdeja mbi shtatë gjymtyrët, ngritja prej saj, ulja mes dy sexhdeve, qetësia në të gjitha veprimet, ruajtja e renditjes midis shtyllave të namazit, teshehudi i fundit, ulja në të, salavatet mbi Profetin ﷺ, dhe dy selamet.

Mësimi i tetë: Vaxhibet e namazit (veprimet e detyrueshme).

Vaxhibet e namazit janë tetë:

Të gjitha tekbiret përveç tekbirit fillestar, thënia: “Semiallahu limen hamideh” për imamin dhe atë që falet vetëm, thënia: “Rabbena ue lekel-hamd” për të gjithë, thënia: “Subhane rabbijel-adhim” në ruku, thënia: “Subhane rabbijel-a'la” në sexhde, thënia: “Rabbi igfir li” mes dy sexhdeve, teshehudi i parë dhe ulja në të.

Mësimi i nëntë: Forma e Teshehudit.

Teshehudi thuhet në këtë mënyrë:

Et-teḥijjātu lil-lāhi ueṣ-ṣaleuātu, ueṭ-ṭajjibātu, es-selāmu ‘alejke ej-juhen-nebij-ju ue raḥmetull-lāhi ue berakātuhu, es-selāmu ‘alejnā ue ‘alā ‘ibādil-lāhiṣ-ṣāliḥīn, esh'hedu en lā ilāhe il-lAll-llāh, ue esh'hedu en-ne Muḥam-meden ‘abduhu ue rasūluhu.

Pastaj dërgon salavatet dhe bekimet mbi Profetin ﷺ, duke thënë: All-llāhumme ṣal-li ‘alā Muḥam-medin ue ‘alā āli Muḥam-medin, kemā ṣal-lejte ‘alā Ibrāhīme ue ‘alā āli Ibrāhīme, in-neke Ḥamīdun Mexhīd. Ue bārik ‘alā Muḥam-medin Ue ‘alā āli Muḥam-medin, kemā bārakte ‘alā Ibrāhīme Ue ‘alā āli Ibrāhīme, in-neke Ḥamīdun Mexhīd.

Pastaj, në teshehudin e fundit, kërkon mbrojtjen e Allahut nga dënimi i Xhehenemit, nga dënimi i varrit, nga sprova e jetës dhe vdekjes, dhe nga

sprova e mesihut Dexhal. Pastaj, zgjedh çfarëdo lutjeje që dëshiron, veçanërisht nga ato të transmetuara nga Profeti (paqja qoftë mbi të), si p.sh.:

O Allah! Më ndihmo të të përmend, të të falënderoj dhe të të adhuroj në mënyrën më të mirë. O Allah, unë i kam bërë shumë padrejtësi vetvetes. Askush përveç Teje nuk i fal gjynahet, ndaj më fal mua me mirësinë Tënde dhe më mëshiro, se Ti je Falës dhe Mëshirues!

Në teshehudin e parë, pas dy shehadeteve, ngrihet për rekatin e tretë në namazin e drekës, ikindisë, akshamit dhe jacisë. Nëse dërgon salavate mbi Profetin (paqja qoftë mbi të) është më mirë për shkak të haditheve të përgjithëshme që flasin për këtë çështje, pastaj ngrihet për rekatin e tretë.

Mësimi i dhjetë: Sunetet e namazit.

Disa nga sunetet e namazit janë:

1) Duaja hyrëse.

2) Vendosja e dorës së djathtë mbi të majtën në gjoks gjatë qëndrimit në këmbë, para rukusë dhe pas ngritjes nga rukuja.

Ngritja e duarve me gishtat e bashkuar dhe të shtrirë paralel me supet ose me veshët gjatë tekbitit të parë, kur nisemi të shkojmë në ruku dhe kur ngrihemi prej saj, dhe kur ngrihemi nga teshehudi i parë për në rekatin e tretë.

4) Bërja e dhikrit më shumë se një herë në ruku dhe sexhde.

5) Çdo dhikër shtesë mbi thënien: 'Rabbena ue lekel-hamd' pas ngritjes nga rukuja, dhe bërja më shumë se një herë e istigfarit ndërmjet dy sexhdeve.

6) Mbajtja e kokës paralel me shpinën në ruku.

7) Mbajtja e llërave të ndara nga ijet, barku të mos prekë kofshët dhe kofshët të mos prekin kërcinjtë gjatë sexhdes.

8) Ngritja e parakrahëve nga toka gjatë sexhdes.

9) Ulja e faltarit (namazliu) mbi këmbën e majtë të shtrirë, duke e mbajtur të djathtë të ngritur, në teshehudin e parë dhe ndërmjet dy sexhdeve.

10) Ulja në formën e teverrukut në teshehudin e fundit të namazeve me katër dhe tre rekate. Forma e kësaj uljeje është: vendosja e të ndenjurrave në tokë, duke e futur këmbën e majtë poshtë të djathtës dhe duke e mbajtur të djathtë të ngritur drejt.

11) Ngritja e gishtit tregues në teshehudin e parë dhe të dytë, që nga momenti i uljes deri në fund të teshehudit, dhe lëvizja e tij gjatë lutjes.

12) Të çohen salavatet për Muhamedin dhe familjen e tij, si dhe për Ibrahimin dhe familjen e tij në teshehudin e parë.

13) Lutja në teshehudin e fundit.

14) Leximi me zë në namazin e sabahut, namazin e xhumasë, namazet e dy bajrameve, namazin e

istiskasë (lutjes për shi), dhe në dy rekatet e para të namazit të akshamit dhe jacisë.

15- Leximi me zë të ulët në drekë, ikindi, në rekatën e tretë të akshamit dhe në dy rekatet e fundit të jacisë.

16) Leximi i pjesëve të Kuranit pas sures Fatiha. Gjithashtu respektimi i të gjitha suneteve të tjera në namaz përveç atyre që kemi përmendur, si: thënia e dhikrit pas thënies: (Rabbena ue lekel hamd), pas ngritjes nga rukuja për imamin, xhematin dhe individin, konsiderohet sunet. Gjithashtu, vendosja e duarve mbi gjunjë me gishta të hapur gjatë rukusë.

Mësimi i njëmbëdhjetë: Gjërat që e bëjnë namazin të pavlefshëm.

Gjërat që e prishin namazin janë tetë:

1. Të folurit qëllimisht, me vetëdije, duke e ditur që një gjë e tillë e prish namazin, ndërsa ai që flet nga harresa dhe nga padija, namazi i tij nuk priset.

2) E qeshura.

3) Ngrënia.

4) Pirja.

5) Zbulimi i aures (vendeve të turpshme).

6) Mënjanimi i madh nga drejtimi i kibles.

7) Lëvizjet e kota të shumta dhe të pandërprera gjatë namazit.

8) Prishja e abdesit.

Mësimi i dymbëdhjetë: Kushtet e abdesit.

Kushtet e abdesit janë dhjetë:

Islami, arsyëja, aftësia për të dalluar të mirën nga e keqja, qëllimi dhe vendosja se do ta kryej abdesin deri në fund, ndërprerja e shkaqeve që e prishin abdesin, pastrimi i nga nevoja e trashë apo e hollë me ujë ose me gurë para abdesit, uji që do të përdoret për abdes të jetë i pastër dhe i ligjshëm, heqja e gjërave që pengojnë arritjen e ujit deri te lëkura, dhe hyrja e kohës së namazit për atë që vuan nga një papastërti e përhershme.

Mësimi i trembëdhjetë: Farzet e abdesit.

Farzet e abdesit janë gjashtë:

Larja e fytyrës përfshirë shpëlarjen e gojës dhe pastrimin e hundës, larja e duarve së bashku me bërrylat, fërkimi i gjithë kokës përfshirë edhe veshët, larja e këmbëve së bashku me kyçet, ruajtja e radhës dhe larja në mënyrë të njëpasnjëshme. Pëlqehet përsëritja e larjes së fytyrës, duarve dhe këmbëve nga tri herë, po ashtu edhe shpëlarja e gojës dhe e hundës, ndërsa obligim (vaxhib) është të lahen një herë. Sa i përket lagies (mes'hit) së kokës, nuk pëlqehet përsëritja e saj, siç dëshmojnë hadithet e sakta.

Mësimi i katërbëdhjetë: Gjërat që e prishin abdesin.

Gjërat që e prishin abdesin janë gjashtë:

Çdo gjë që del përmes dy kanaleve të jashtëqitjes, çdo gjë e pistë që del në sasi të shumtë nga trupi, humbja e vetëdijes nga gjumi apo nga ndonjë shkak tjetër, prekja e vendeve të turpshme me dorë në mënyrë të drejtpërdrejtë, qoftë përpara apo prapa, ngrënia e mishit të devesë, dhe braktisja e Islamit, Allahu na ruajtë neve dhe muslimanët nga ajo.

Një vërejtje e rëndësishme: Sa i përket larjes së xhenazes, mendimi i saktë është se ajo nuk e prish abdesin, dhe ky është mendimi i shumicës së dijetarëve, për shkak të mungesës së provave për të kundërtën. Megjithatë, nëse dora e larësit prek organin intim të të vdekurit në mënyrë të drejtpërdrejtë, atëherë abdesi i tij prishet.

Ai që lan xhenazen duhet që të mos prekë organin intim të të vdekurit në mënyrë të drejtpërdrejtë. Po ashtu, prekja e gruas nuk e prish abdesin në asnjë rast, qoftë me epsh apo pa epsh, sipas mendimit më të saktë të dijetarëve, përderisa nuk del asgjë nga organi intim, sepse Profeti ﷺ puthi njërën nga gratë e tij dhe pastaj fali namazin pa marrë abdes.

Sa i përket fjalës së Allahut në ajetet e sures en-Nisa dhe el-Maide:

{...أَوْ لَمَسْتُمُ النِّسَاءَ...}

"...ose nëse keni prekur gratë..." (en-Nisa, 43)
(el-Maide, 6) Fjala "keni prekur" ka për qëllim

marrëdhëniet intime, sipas mendimit më të saktë të dijetarëve, që është edhe mendimi i Ibën Abasit (Allahu qoftë i kënaqur me të) dhe i një grupi të dijetarëve të hershëm dhe të vonshëm. Suksesi është në Dorë të Allahut.

Mësimi i pesëmbëdhjetë: Stolisja e muslimanit me virtytet që na urdhëron sheriati.

Ndër to janë: çiltërsia, besnikëria, ndershmëria, turpi, trimëria, bujaria, besa, ruajtja e vetes nga çdo gjë që Allahu e ka ndaluar, fqinjësia e mirë, ndihmesa e nevojtarëve sipas mundësisë, dhe të tjera virtyte që Kurani ose suneti kanë dëshmuar për stolisjen me to.

Mësimi i gjashtëmbëdhjetë: Edukimi i vetes me normat islame.

Disa nga normat islame janë: përshëndetja me selam, fytyra e qeshur, ngrënia dhe pirja me dorën e djathtë, përmendja e emrit të Allahut në fillim të ngrënies dhe falënderimi i Tij kur përfundon, thënia "elhamdulillah" pas teshtitjes, lutja për atë që teshtin nëse falënderon Allahun, vizita e të sëmurit, përcjellja e xhenazes: falja e namazit dhe pjesëmarrja në varrim, etika fetare kur hyn në xhami ose në shtëpi dhe kur del prej tyre, normat fetare gjatë udhëtimit, mirësjellja me prindërit, të afërmit dhe fqinjët, të mëdhenjtë dhe të vegjlit,

urimi për lindjen e fëmijës, urimi për martesën, ngushëllimi në rast fatkeqësie, gjithashtu dhe norma të tjera islame që lidhen me veshjen dhe heqjen e rrobave dhe me veshjen dhe heqjen e këpucëve...etj.

Mësimi i shtatëmbëdhjetë: Paralajmërimi kundër shirkut (idhujtarisë) dhe llojeve të ndryshme të mëkateve.

Ndër to janë: shtatë mëkatet fundosëse (shkatërruese), që janë: bërja ortak Allahut, magjia, vrasja padrejtësisht e atij që e ka ndaluar Allahu, përveçse me të drejtë, ngrënia e kamatës, ngrënia e pasurisë së jetimit, ikja nga fronti i luftës dhe shpifja për gratë e ndershme, besimtare e të pastra.

Ndër to janë edhe: mosrespektimi i prindërve, ndërprerja e lidhjeve farefisnore, dëshmia e rreme, betimet e rreme, shqetësimi i fqinjit, padrejtësia ndaj njerëzve në derdhjen e gjakut të pafajshëm, në pasuri dhe në nder, pirja e pijeve dehëse, pjesëmarrja në lojërat e fatit - kumar - përgojimi, shpifja dhe mëkate të tjera që Allahu i Lartësuar ose i Dërguari i Tij ﷺ i kanë ndaluar.

Mësimi i tetëmbëdhjetë: Përgatitja e xhenazes, falja e namazit të xhenazes dhe varrimi.

Kjo është forma e detajuar e kësaj teme:

1-Prej normave të fesë është t'ia kujtojmë të sëmurit, i cili është në shtratin e vdekjes fjalën: (La ilahe il-lallah); ngase Profeti ﷺ ka porositur:

«لَقِّنُوا مَوْتَانَكُمْ: لَا إِلَهَ إِلَّا اللَّهُ» [7]

"Kujtojuani të vdekurve tuaj fjalën 'la ilahe il-lallah' "(7)¹ E ka transmetuar Muslimi në "Sahihun" e tij. Me fjalën "të vdekurit" në këtë hadith nënkuptohen ata që janë në prag të vdekjes, pra ata të cilëve u janë shfaqur shenjat e vdekjes.

2- Pasi të sigurohemi që ka vdekur, i mbyllen sytë dhe i lidhen nofullat, pasi që kështu përcillet nga Pejgamberi (paqja qoftë mbi të).

3- Duhet të bëhet larja e xhenazes së muslimanit, me përjashtim të atij që ka rënë dëshmor në betejë, këtij nuk lahet trupi dhe nuk i falet namazi i xhenazes, por varroset me rrobat e tij; sepse Profeti ﷺ nuk i lau dëshmorët e Uhudit dhe nuk ua fali namazin e xhenazes.

**Të mbulohen vendet intime të xhenazes,
pastaj të ngrihet pak dhe t'i shtypet barku
lehtë, pastaj ai që është duke e larë të
mbështjellë një copë pëlhere ose diçka të
ngjashme rreth dorës së tij dhe t'i pastrojë
vendet intime me të, pastaj t'i japë abdes si
për namaz, pastaj t'i lajë kokën dhe**

¹ E ka transmetuar Muslimi nr. (916-917).

mjekrën me ujë dhe sidër ose diçka të ngjashme, pastaj të lajë anën e djathtë dhe pastaj të majtën, pastaj ta lajë sërish për herë të dytë dhe të tretë, duke e vendosur dorën mbi barkun e tij në çdo herë, dhe nëse del diçka nga vendet intime, ta lajë dhe ta mbyllë vendin intim me pambuk ose diçka të ngjashme, e nëse nuk qëndron, atëherë me baltë të njomë, ose me mjete moderne mjekësore, si: likoplast...etj.

E përsërit abdesin e xhenazes nga fillimi, e nëse nuk pastrohet pasi ta ketë larë tri herë, e shton larjen deri në pesë herë, ose deri në shtatë herë, pastaj e than me një rrobë, dhe vendos parfum në sqetullat e tij dhe në gjymtyrët e sexhdes, e nëse e parfumos të gjithë trupin, është më mirë. I tymos me temjan qefinët e tij, i shkurton mustaqet apo thonjtë nëse janë të gjatë, e nëse i lë, nuk ka problem. Nuk ia kreh flokët, nuk ia rruan qimet në vendet intime, dhe nuk e bën synet; për shkak të mungesës së argumentit për këtë. Gruas i gërshetohen flokët në tre gërsheta dhe i lëshohen nga pas.

5- Qefinosja e xhenazes.

Forma më e mirë është që burri të qefinoset me tri pëlhura të bardha, pa këmishë dhe pa çallmë, ashtu siç u qefinos Profeti ﷺ, duke e mbështjellë në

to. Nëse qefinoset me këmishë, izar (pëlhurë që mbulon brezin e poshtë) dhe një pëlhurë të madhe që mbulon krejt trupin, nuk ka problem.

Gruaja mbështillet me pesë rroba: këmishë, shami, izar dhe dy pëlhura që mbështjellin gjithë trupin. Djali i vogël mbështillet me një deri në tre rroba, ndërsa vajza e vogël mbështillet me këmishë dhe dy pëlhura që mbështjellin gjithë trupin.

Kjo që cekëm më lart është forma e pëlqyeshme e qefinit ndërsa forma e detyrueshme për të gjithë të vdekurit është që të qefinosen me një rrobë që mbulon të gjithë trupin e të vdekurit. Nëse i vdekuri është në ihram, ai lahet me ujë dhe sidër, dhe mbështillet në dy pëlkurat e ihramit ose në diçka tjetër, pa ia mbuluar kokën dhe fytyrën, dhe pa e parfumuar; sepse ai do të ringjallet Ditën e Kiametit duke bërë telbijen (në gjendjen e ihramit), siç është vërtetuar në hadithin e Profetit ﷺ. Nëse personi që ka vdekur është grua dhe është në ihram, ajo qefinoset si gratë e zakonshme, vetëm se nuk parfumoset, dhe fytyra e saj nuk mbulohet me nikab, as duart me doreza, fytyra dhe duart i mbulohen me qefinin në të cilin është mbështjellë, siç është shpjeguar më herët kur folëm për formën e qefinosjes së gruas.

6- Personi të cilit i takon më tepër të lajë xhenazen, t'i fali namazin dhe ta varrosë.

Kjo detyrë i takon më tepër atij personi për të cilin e ka lënë i ndjeri me testament. Nëse nuk e ka

lënë me testament atëherë i takon babait, pastaj gjyshit, pastaj me radhë sipas afërsisë së gjakut me të ndjerin. Kjo renditje respektohet kur personi i vdekur ka qenë burrë.

Ndërsa sa i takon gruas, njeriu që e meriton më tepër ta lajë atë është ajo grua për të cilën ajo e ka lënë me testament. Nëse nuk ka lënë testament atëherë i takon nënës, pastaj gjyshes, pastaj më e afërta nga gratë e fisit. Bashkëshortët mund të lajnë njëri-tjetrin; sepse Ebu Bekrin (Allahu qoftë i kënaqur me të) e lau grua e tij, dhe Aliu (Allahu qoftë i kënaqur me të) lau gruan e tij Fatimen (Allahu qoftë i kënaqur me të).

7- Forma e namazit të xhenazes.

Themi "All-llahu ekber" katër herë: pas tekbirit të parë lexojmë suren "el-Fatiha", dhe nëse lexojmë bashkë me të një sure të shkurtër ose një ajet apo dy ajete, konsiderohet si diçka e mirë ; bazuar në hadithin e saktë që përcillet për këtë çështje nga Ibën Abbasi (Allahu qoftë i kënaqur me të). Pastaj themi "All-llahu ekber" për herë të dytë dhe themi salavatet për Profetin ﷺ sikurse në teshehud, pastaj themi "All-llahu ekber" për herë të tretë, dhe themi: All-llāhummeḡfir liḥajjina ue mejjitina, ue shahidina ue ḡaibina, ue ṣaḡirina ue kebirina, ue dhekerina ue unthana! All-llāhumme men aḥjejtehu minna fe aḥjihi alel-Islam, ue men teueffejtehu minna fe teueffehu alel-Iman! All-llāhummeḡfir lehu, uerḥamhu, ue aḡfihi, ue a'fu anhu, ue ekrim

nuzulehu, ue ues-si' mudkhalehu, ueğsilhu bil-mai
ue th-thelxhi ue el-berad, ue nek-kihi minel-ḥaṭaja
kema junek-kath-theubu el-ebjedu mined-denes!
Ue ebdilhu daran ḥajran min darihi, ue ehlen ḥajran
min ehlihi, ue ed'hilhul-xhennete, ue eidhhu min
adhabil-ḡabri, ue adhabin-nari, uefseḡ lehu fi
ḡabrihi, ue nev-vir lehu fihi! All-llāhumme la
taḥrimna exhrehu ue la tuḡil-lena ba'dehu! Pastaj
themi tekbirin e katërt dhe japim një selam në anën
e djathtë.

Rekomandohet që të ngrihen duart me çdo
tekbir, dhe nëse i vdekuri është grua atëherë lutja
bëhet në gjininë femërore. Nëse janë dy xhenaze
apo më shumë, lutja bëhet në numrin shumë. Ndërsa nëse është fëmijë, në vend të lutjes për falje
thuhet: "O Allah, bëje atë një paraprirës, shpërblim
dhe ndërmjetësues të pranuar për prindërit e tij! O
Allah, rëndoje me të peshoret e prindërve dhe
shumëfishoi shpërblimet e tyre përmes tij!
Bashkoje atë me të mirët e besimtarëve të
mëparshëm dhe vendose atë nën kujdesin e
Ibrahimit (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi
të) dhe me mëshirën Tënde mbroje atë nga dënimi
i Xhehenemit!

Prej sunetit është që imami të qëndrojë në
drejtim të kokës së burrit dhe në mes të trupit të
gruas. E nëse janë disa xhenaze me gjini të
ndryshme, atëherë para imamit vendoset xhenazja
e burrit ndërsa xhenazja e gruas të jetë më afër

kiblës. Nëse ka gra dhe fëmijë, atëherë djali vendoset para gruas, pastaj vendoset gruaja dhe pastaj vajza. Koka e djalit të jetë paralel me kokën e burrit, mesi i trupit të gruas paralel me kokën e burrit, dhe koka e vajzës të jetë paralel me kokën e gruas ndërsa mesi i saj paralel me kokën e burrit. Të gjithë namazlinjtë të rreshtohen pas imamit, përveç nëse dikush nuk gjen vend pas imamit, atëherë ai qëndron në të djathtën e imamit.

8- Mënyra e varrosjes së të vdekurit.

Sipas rregullit fetar varri duhet të jetë i thellë sa gjysma e trupit të burrit, dhe të ketë një lahd (zgavër) nga ana e kiblës, dhe i vdekuri të vendoset në lahd në anën e tij të djathtë. Të zgjidhen lidhëset e qefinit, por të mos hiqen, dhe të mos zbulohet fytyra, qoftë i vdekuri burrë apo grua. Pastaj të vendosen mbi të tulla dhe të suvatohen me baltë të njomë që të qëndrojnë dhe ta mbrojnë nga dheu. Nëse nuk ka tulla, atëherë me diçka tjetër si dërrasa, gurë, apo dru që ta mbrojnë nga dheu. Pastaj të mbulohet me dhe. Është e pëlqyeshme të thuhet në atë moment: (Bismil-lahi, ue ala mil-leti Resulil-lah). Varri të ngrihet rreth një pëllëmbë, dhe të vendosen mbi të gurë të vegjël nëse është e mundur, dhe të spërkatet me ujë.

Prej normave fetare është që ata që përcjellin të vdekurin të qëndrojnë pranë varrit dhe të luten për të; sepse Profeti ﷺ, kur përfundonte varrimin e të vdekurit, qëndronte pranë tij dhe thoshte:

«اسْتَغْفِرُوا لِأَخِيكُمْ، وَسَلُّوا لَهُ التَّائِبَتِ، فَإِنَّهُ الْآنَ يُسَالُ» [8].

"Kërkoni falje për vëllanë tuaj dhe kërkoni për të qëndrueshmëri, sepse tani po pyetet." (8)¹

9- Është e lejueshme për atë që nuk ia ka falur të vdekurit namazin e xhenazes, ta falë atë pas varrosjes së tij;

ngase Profeti ﷺ e ka bërë një gjë të tillë, me kusht që kjo të jetë brenda një muaji ose më pak. Nëse periudha është më e gjatë se kaq, nuk është e ligjshme falja e namazit të xhenazes te varri, sepse nuk është transmetuar që Profeti ﷺ t'ia ketë falur dikujt namazin e xhenazes te varri pas një muaji nga varrimi i të vdekurit.

10- Nuk lejohet që familjarët e të vdekurit të përgatisin ushqim për njerëzit; bazuar në atë që ka thënë sahabiu i nderuar Xherir ibën Abdullah el-Bexheli (Allahu qoftë i kënaqur me të!):

«كُنَّا نَعُدُّ الْاجْتِمَاعَ إِلَى أَهْلِ الْمَيِّتِ وَصَنْعَةَ الطَّعَامِ بَعْدَ الدَّفْنِ مِنَ النَّبَاحَةِ» [9]

"E konsideronim mbledhjen te familja e të vdekurit dhe përgatitjen e ushqimit pas varrimit si pjesë të vajtimit". (9)² E transmetoi imam Ahmedi me një zinxhir të mirë të transmetimit.

Sa i përket përgatitjes së ushqimit për familjarët ose për mysafirët e tyre, nuk ka problem, dhe është e rekomanduar që të afërmit dhe fqinjët e tyre të përgatisin ushqim për ta; sepse kur Profeti ﷺ mori

¹ Transmetoi Ebu Daudi nr. 3221, dhe Hakimi (3/399).

² E transmetuan Ibën Maxheh, nr. 1612 dhe Imam Ahmedi 2/204.

lajmin për vdekjen e Xhafer ibën Ebi Talibit (Allahu qoftë i kënaqur me të!) në tokat e Shamit, ai urdhëroi familjen e tij që të përgatisnin ushqim për familjen e Xhaferit, dhe tha:

«إِنَّهُ أَتَاهُمْ مَا يَشْعُلُهُمْ» [10].

"Me të vërtetë, ata po përjetojnë një situatë që i preokupon nga ushqimi". (10)¹

Nuk është gjynah për familjarët e të vdekurit që të ftojnë fqinjët e tyre, ose të tjerët për të ngrënë nga ushqimi që u është dhuruar atyre, dhe për këtë nuk ka kohë të caktuar sipas asaj që dimë nga sheriat.

11-Nuk i lejohet gruas të mbajë zi për një të vdekur më shumë se tri ditë, përveçse për burrin e saj.

Për burrin, ajo duhet të mbajë zi katër muaj e dhjetë ditë, përveç nëse është shtatzënë, me ç'rast ajo duhet të mbajë zi deri në lindjen e fëmijës; sepse kjo është e vërtetuar nga suneti i saktë i Pejgamberit ﷺ.

Sa i përket burrit, nuk i lejohet të mbajë zi për askënd nga të afërmit apo të tjerë.

12- Vizita e varreve është e ligjësuar për burrat herë pas here për të bërë lutje për të vdekurit, për

¹ E transmetuan Muslimi, në kapitullin: "Xhenazetë", nr.(976), Nesaiu, në kapitullin: "Xhenazetë", nr. (2034), Ebu Davudi, në kapitullin: "Xhenazetë", nr. (3234), Ibn Maxhe, në kapitullin: "Hadithet që janë transmetuar për xhenazetë", nr. (1569) dhe Ahmedi, (2/441).

të kërkuar mëshirë për ta dhe për të kujtuar vdekjen dhe jetën pas saj.

Bazuar në thënien e Pejgamberit ﷺ:

«رُزُوا الْقُبُورَ، فَإِنَّهَا تُذَكِّرُكُمْ الْآخِرَةَ» [11]

"Vizitoni varret, sepse ato ju kujtojnë Ahiretin".¹ E transmetoi Muslimi në "Sahihun" e tij.

Pejgamberi ﷺ i mësonte shokët e tij që kur vizitonin varret të thoshin:

«السَّلَامُ عَلَيْكُمْ أَهْلَ الدِّيَارِ مِنَ الْمُؤْمِنِينَ وَالْمُسْلِمِينَ، وَإِنَّا إِن شَاءَ اللَّهُ بِكُمْ لَاجِقُونَ، نَسْأَلُ اللَّهَ لَنَا وَلَكُمْ الْعَافِيَةَ، يَرْحَمُ اللَّهُ الْمُتَقَدِّمِينَ مِنَّا وَالْمُسْتَأَخِرِينَ» [12].

"Paqja qoftë mbi ju, o banorë të këtyre varrezave, prej besimtarëve dhe muslimanëve. Edhe ne, nëse do Allahu, do t'ju bashkohemi. Kërkojmë prej Allahut mirësi për veten dhe për ju. Allahu i mëshiroftë të parët dhe të fundit nga ne".(12)²

Sa i përket grave, atyre nuk u lejohet të vizitojnë varret, sepse Profeti (paqja qoftë mbi të!) i ka mallkuar gratë që vizitojnë varret, dhe nga frika se vizita e tyre mund të sjellë probleme dhe mungesë të durimit. Po ashtu, nuk u lejohet të ndjekin xhenazen deri në varreza, sepse Profeti (paqja qoftë mbi të!) i ka ndaluar ato nga një gjë e tillë. Namazi i xhenazes në xhami ose në musal-la është i lejuar për burrat dhe për gratë pa dallim.

Këtu u erdhi fundi këtyre mësimëve që na u dha mundësia t'i përpilojmë. Salavatet dhe selamet

¹ E ka cituar Ibën Maxheja, nr. 1569, dhe e ka saktësuar Albani.

² Transmetoi Muslimi nr.975

qofshin për profetin tonë Muhamedin si dhe për familjen dhe shokët e tij!

Përmbajtja

Mësime të rëndësishme për popullin e thjeshtë	2
Mësime të rëndësishme për popullin e thjeshtë	2
Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit!	2
Parathënia e autorit	2
Mësimi i parë: Surja el-Fatiha dhe suret e shkurtra.	3
Mësimi i dytë: Shtyllat e Islamit.....	3
Mësimi i tretë: Shtyllat e Imanit (besimit).	4
Mësimi i katërt: Llojet e teuhidit dhe llojet e shirkut.	4
Mësimi i pestë: Ihsani (përsosmëria).....	10
Mësimi i gjashtë: Kushtet e namazit.	10
Mësimi i shtatë: Shtyllat e namazit.....	10
Mësimi i tetë: Vaxhibet e namazit (veprimet e detyrueshme).	11
Mësimi i nëntë: Forma e Teshehudit.	11
Mësimi i dhjetë: Sunetet e namazit.	12
Mësimi i njëmbëdhjetë: Gjërat që e bëjnë namazin të pavlefshëm.	14
Mësimi i dymbëdhjetë: Kushtet e abdesit.	15
Mësimi i trembëdhjetë: Farzet e abdesit.	15
Mësimi i katërbëdhjetë: Gjërat që e prishin abdesin.....	15
Mësimi i pesëmbëdhjetë: Stolisja e muslimanit me virtytet që na urdhëron sheriati.....	17
Mësimi i gjashtëmbëdhjetë: Edukimi i vetes me normat islame.	17
Mësimi i shtatëmbëdhjetë: Paralajmërimi kundër shirkut (idhujtarisë) dhe llojeve të ndryshme të mëkateve.....	18
Mësimi i tetëmbëdhjetë: Përgatitja e xhenazes, falja e namazit të xhenazes dhe varrimi.	18

Të mbulohen vendet intime të xhenazes, pastaj të ngrihet pak dhe t'i shtypet barku lehtë, pastaj ai që është duke e larë të mbështjellë një copë pëlhure ose diçka të ngjashme rreth dorës së tij dhe t'i pastrojë vendet intime me të, pastaj t'i japë abdes si për namaz, pastaj t'i lajë kokën dhe mjekrën me ujë dhe sidër ose diçka të ngjashme, pastaj të lajë anën e djathtë dhe pastaj të majtën, pastaj ta lajë sërish për herë të dytë dhe të tretë, duke e vendosur dorën mbi barkun e tij në çdo herë, dhe nëse del diçka nga vendet intime, ta lajë dhe ta mbyllë vendin intim me pambuk ose diçka të ngjashme, e nëse nuk qëndron, atëherë me baltë të njomë, ose me mjete moderne mjekësore, si: likoplast...etj..... 19